

VENDIM
Nr. 387, datë 13.5.2020

**PËR MIRATIMIN E GARANCISË SHTETËRORE TË HUAS ME BANKAT
TREGTARE PËR GARANTIMIN E HUAMARRJES SË TREGTARËVE OSE
SHOQËRIVE TREGTARE PËR TË MUNDËSUAR FINANCIMIN E NEVOJSHËM
PËR RIMËKËMBJEN E AKTIVITETIT TREGTAR TË NDIKUAR NGA SITUATA
E KRIJUAR NGA COVID-19, SI EDHE PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE E TË
KRITEREVE TË MARRËVESHJES SË GARANCISË DHE MARRËVESHJES SË
MIRËKUPTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 e 38, të ligjit nr.9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 57, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e linjës së garancisë shtetërore në vlerën 15 000 000 000 (pesëmbëdhjetë miliardë) lekë, në favor të bankave tregtare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, pjesë e skemës së garancisë që do të mundësojë huadhënien për tregtarët dhe shoqëritë tregtare për të siguruar fondet e nevojshme për kapital qarkullues dhe investime për të mbështetur rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar që është ndikuar nga situata e krijuar nga COVID-19.

2. Linja e garancisë shtetërore, që lëshohet në favor të secilës bankë tregtare, është, si më poshtë vijon:

- Raiffeisen Bank sh.a. Albania, deri në vlerën	2 600 000 000 lekë;
- <u>Banka Tirana sh.a.</u> deri në vlerën	850 000 000 lekë;
- <u>Banka Union sh.a.</u> deri në vlerën	800 000 000 lekë;
- <u>Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a.</u> deri në vlerën	1 200 000 000 lekë;
- <u>Banka Kombëtare Tregtare sh.a.</u> deri në vlerën	2 550 000 000 lekë;
- <u>Banka OTP Albania sh.a.</u> deri në vlerën	1 450 000 000 lekë;
- <u>Banka Procredit sh.a.</u> deri në vlerën	600 000 000 lekë;
- <u>Banka Alpha Albania sh.a.</u> deri në vlerën	950 000 000 lekë;
- <u>Banka Amerikane e Investimeve sh.a.</u> deri në vlerën	650 000 000 lekë;
- <u>Banka Credins sh.a.</u> deri në vlerën	2 800 000 000 lekë;
- <u>Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a.</u> deri në vlerën	150 000 000 lekë;
- <u>Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a.</u> deri në vlerën	400 000 000 lekë.

3. Marrëveshjet e garancisë janë sipas kushteve dhe kritereve të marrëveshjes tip që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka të drejtë që, pas 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjeve përkatëse, nëse është e nevojshme, sipas raportit të strukturës së posaçme ndërinstitucionale, i propozon Këshillit të Ministrave rialokimin e shumës së garancisë, nga huadhënësi që nuk e ka ezuaruar shumën e garancisë në favor të tij te huadhënësi që e ka ezuaruar atë plotësisht.

5. Autorizohet ministri i Financave dhe Ekonomisë për nënshkrimin e marrëveshjeve të garancisë me secilën nga bankat tregtare.

6. Marrëveshja e mirëkuptimit, e cila nënshkruhet nga huamarrësi, përmban kushtet dhe kriteret sipas marrëveshjes tip të integruar si aneks në marrëveshjen tip të përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi.

7. Kryeministri miraton me urdhër strukturën e posaçme ndërinstitucionale, e cila monitoron, shqyrton dhe raporton periodikisht pranë ministrit të Financave dhe Ekonomisë në lidhje me ecurinë e garancisë shtetërore, si dhe trajton çështje mbi mbarëvajtjen dhe unifikimin e zbatimit të parashikimeve të kësaj marrëveshjeje.

8. Ministria e Financave dhe Ekonomisë mund të kërkojë këshillim/asistencë nga Banka e Shqipërisë, gjatë implementimit të marrëveshjeve të garancisë. Ky bashkëpunim mund të rregullohet edhe nëpërmjet një memorandum bashkëpunimi.

9. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për ndjekjen e procedurave të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

[Banka XYZ]

Këshilli i Ministrave
Përfaqësuar nga
Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Nr. _____ Prot.
Tiranë, më _____.____.2020

Nr. _____ Prot.
Tiranë, më _____.____.2020

**MARRËVESHJE GARANCIE
PËR GARANTIMIN E HUAMARRJES SË TREGTARËVE OSE SHOQËRIVE
TREGTARE PËR TË MUNDËSUAR FINANCIMIN E NEVOJSHËM PËR
RIMËKËMBJEN E AKTIVITETIT TREGTAR TË NDIKUAR NGA SITUATA E
KRIJUAR NGA COVID-19 (MARRËVESHJE TIP)**

[XXXXXXX] Lekë

Data e Hyrjes në Fuqi
[_____]

PREAMBUL

Qëllimi i skemës së garancisë është që të stimulojë huadhënien nga bankat tregtare që operojnë në Republikën e Shqipërisë, për t'i mundësuar tregtarëve ose shoqërive tregtare financimin e nevojshëm për të rimëkëmbur aktivitetin e tyre tregtar, i cili është prekur direkt ose indirekt nga

aktet ligjore dhe nënligjore të qeverisë në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19.

Kjo marrëveshje garancie (“Marrëveshja e Garancisë”) e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (“MFE”) dhe Bankës XYZ. (“Huadhënësi”), bëhet për të përcaktuar kushtet e pjesëmarrjes së Huadhënësit në këtë skemë garancie të administruar nga MFE-ja (ose çdo strukture tjetër të autorizuar nga MFE-ja).

Marrëveshja e Garancisë nuk përbën detyrim të drejtpërdrejtë për shtetin (në këtë Marrëveshje përfaqësuar nga MFE)-ja, por përfaqëson një detyrim të mundshëm të tij. Ky detyrim kthehet në detyrim të drejtpërdrejtë në rastin kur përfituesi i drejtpërdrejtë i huasë (“Huamarrësi”) nuk ka arritur të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar (“Huaja”), në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë (“Marrëveshja e Huasë”) dhe janë plotësuar kushtet e parashikuara shprehimisht në këtë Marrëveshje.

Për sa më sipër, si edhe për të mundësuar realizimin e qëllimit të kësaj Marrëveshjeje palët bien dakord me kushtet si më poshtë:

Neni 1 (Baza ligjore)

Kjo Marrëveshje është hartuar në zbatim të:

- Neneve 34-43 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Nenit 57 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Aktit normativ nr. 15, datë 15.4.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar;
- Pikës 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore”;
- Vendimit të Kuvendit nr.18/2020, “Për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore”, të shpallur me vendimin nr. 243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore”, deri në datën 23.6.2020;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.xxx, datë _____ “Për.....”.

Neni 2 (Garancia)

1. MFE-ja merr përsipër të garantojë Huadhënësin deri në vlerën [XXXXXX] (me fjalë) lekë (“Vlera e Garancisë”), sipas kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara shprehimisht në këtë Marrëveshje. Vlera e Garancisë përfaqëson shumën maksimale të pagesave që do të kryhen nga MFE-ja për të shlyer detyrimet e papaguara ndaj Huadhënësit që burojnë nga Huatë që do t’i nështrohen kësaj skeme garancie.

2. MFE-ja merr përsipër të garantojë deri në Vlerën e Garancisë të cituar në pikën pikën 1 të këtij neni, 60% të principalit të çdo Huaje që Huadhënësi do t’u lëvrojë Huamarrësve sipas kushteve që pasojnë në këtë Marrëveshje.

3. “Vlera e Garantuar e Huasë” do të jetë shuma maksimale e garantuar nëpërmjet kësaj Marrëveshje përkatësisht për secilën nga Huatë e lëvruara nga Huadhënësi, në zbatim të kushteve të kësaj Marrëveshje dhe e cila do të jetë e barabartë me prodhimin e principalit të Huasë me përqindjen e principalit të garantuar nga MFE-ja sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Në asnjë rast, MFE-ja nuk merr përsipër garantimin e interesave, kamatëvonesave, penaltiteteve apo çdo lloj detyrimi tjetër monetar, që mund të burojë nga Huatë që Huadhënësi do t'i lëvrojë Huamarrësve.

5. Shuma maksimale e akumuluar e Vlerës së Garantuar të Huasë që buron nga disbursimet e Huave dhe e përlllogaritur sipas pikës 3 të këtij neni, nuk duhet të tejkalojë Vlerën e Garancisë të cituar në pikën 1 të këtij neni. Çdo disbursim i ri i ndonjë Huaje që tejkalon vlerën e sipërcituar nuk garantohehet nga kjo Marrëveshje, me përjashtim të rastit kur shuma totale e Vlerës së Garantuar të Huasë, së bashku me Vlerën e Garantuar të Huasë që buron nga disbursimi i ri nuk tejkalon Vlerën e Garancisë.

6. Në rastin kur Huadhënësi e ka ezauruar të gjithë Vlerën e Garancisë në dispozicion të tij sipas përcaktimit në pikën 1 të këtij neni, Huadhënësi duhet të njoftojë me shkrim MFE-në brenda një afati prej 5 (pesë) ditë pune.

7. Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka të drejtë që, pas 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjeve përkatëse, nëse është e nevojshme, sipas raportit të strukturës së posaçme ndërinstitucionale, i propozon Këshillit të Ministrave rialokimin e shumës së garancisë, nga huadhënësi që nuk e ka ezauruar shumën e garancisë në favor të tij të huadhënësi që e ka ezauruar atë plotësisht.

Neni 3

(Kriteret e kualifikimit të Huamarrësve dhe kriteret për përfitimin e Huasë)

1. Huadhënësi do të japë Hua të garantuar sipas kësaj Marrëveshje, vetëm Huamarrësve, të cilët plotësojnë kriteret si më poshtë:

a) Huamarrësi duhet të jetë tregtar ose shoqëri tregtare i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me ligjin 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar dhe ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, dhe struktura e kapitalit të zotërohet 100% nga subjekte jopublike.

b) Huamarrësi mund të jetë subjekt që ushtron veprimtarinë tregtare në të gjithë sektorët e ekonomisë, me kusht që veprimtaria e tij tregtare të jetë prekur direkt ose indirekt nga aktet ligjore dhe nënligjore të qeverisë në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19, nëpërmjet mbylljes së përkohshme të aktivitetit tregtar ose nëpërmjet ndikimit me ulje të aktivitetit tregtar.

c) Huamarrësi nuk duhet të ketë detyrime tatimore të papaguara për 3 periudhat tatimore njëkohësisht dhjetor 2019, janar-shkurt 2020, përjashtuar tatimpaguesit të cilët kanë lidhur marrëveshje për pagimin me këste të detyrimeve tatimore si dhe tatimpaguesit, detyrimet e papaguara të të cilëve janë në proces apelimi në të gjitha shkallët.

2. Qëllimi i përdorimit të fondeve të Huasë është për t'i mundësuar Huamarrësit fondet e nevojshme për kapital qarkullues dhe investime për të mbështetur rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar që është prekur nga situata e krijuar nga COVID-19. Në asnjë rast fondet e Huasë nuk do të përdoren për të financuar veprimtari të jashtëligjshme, apo për të rfinansuar hua të tjera.

3. Huamarrësi duhet të nënshkruajë Marrëveshjen e Mirëkuptimit sipas formës dhe përmbajtjes të përcaktuar në aneksin 1, pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

4. Huamarrësi duhet të nënshkruajë formularin e vetëdeklarimit që do t'i vendoset në dispozicion nga Huadhënësi, nëpërmjet të cilit deklaron se:

i. Nuk ka aplikuar dhe nuk ka marrë ndonjë Hua tjetër që mbulohet nga kjo skemë garancie;

ii. Fondet e Huasë do të përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

5. Huamarrësi duhet të dorëzojë kërkesën e aplikimit për Hua pranë Huadhënësit jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

6. MFE-ja gëzon të drejtën që në çdo moment të rishikojë, shtojë ose heqë çdonjërin prej kritereve të cituara në pikat e mësipërme të këtij neni, duke vendosur në dijeni paraprakisht Huadhënësin. Ky ndryshim do të bëhet efektiv menjëherë pas marrjes së njoftimit me shkrim të MFE-së nga Huadhënësi. Asnjë ndryshim i bërë në përputhje me këtë pikë nuk do të ndikojë mbi Huamarrësit, Huaja e të cilëve është aprovuar përpara datës së bërjes efektive të këtij ndryshimi.

7. Me përjashtim të rasteve të veçanta, ashtu si përcaktohet në pikën 6 të këtij neni, Huadhënësi në asnjë rast nuk do të aprovojë kërkesat për Hua të Huamarrësve, të cilët nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikat 1-5 të këtij neni.

Neni 4 **(Detyrimet e Huadhënësit)**

1. Huadhënësi merr përsipër të përdorë format e aplikimit, të cilat garantojnë sigurimin e të gjithë informacionit të cituar në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, sipas praktikave të tij bankare për këto produkte.

2. Huadhënësi mban përgjegjësi për plotësimin e dokumenteve të aplikimit për hua dhe mban kopje të këtyre dokumenteve në arkivat e veta.

3. Huadhënësi merr masat që stafi i burimeve njerëzore, i cili do të angazhohet me huadhënien të ketë ekspertizën e duhur dhe të jetë familjar me politikat dhe procedurat e kësaj skeme garancie.

4. Huadhënësi do t'i trajtojë huatë që do të jenë pjesë e kësaj Marrëveshjeje me profesionalizëm dhe në përputhje me kriteret dhe procedurat e brendshme që ai aplikon gjatë aktivitetit të tij të zakonshëm të kredidhënies për produkte bankare tregtare të ngjashme, si edhe në përputhje me përmbajtjen e nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje.

5. Huadhënësi do të bëjë vlerësimin e riskut të kreditit të Huamarrësve në përputhje me standartet dhe legjislacionin bankar, duke i'u referuar gjendjes financiare të Huamarrësit jo më vonë se muaji shkurt 2020.

6. Huadhënësi duhet të regjistrojë Huanë menjëherë pas lëvrimit në regjistrin e kredive me një emërtim të vecantë "Kredi për kapital qarkullues dhe investime brenda skemës së garancisë shtetërore për situatën e COVID-19".

7. Huadhënësi ka detyrimin të verifikojë nëpërmjet regjistrin të kredive në Bankën e Shqipërisë në momentin e aplikimit për Hua, si edhe përpara disbursimit të Huasë, nëse Huamarrësi është përfitues i ndonjë Huaje brenda të njëjtës skeme garancie nga Huadhënës tjetër. Gjithashtu, Huadhënësi në përputhje me nenin 3, pika 4, duhet t'i vendosë në dispozicion Huamarrësit formularin e vetëdeklarimit, sipas formës dhe përmbajtjes që Huadhënësi e gjykon të arsyeshme.

8. Në rast se Huamarrësi ka marrë një Hua për të njëjtën skemë garancie nga një Huadhënës tjetër, çdo hua tjetër e aprovuar pas Huasë së parë nuk do të jetë objekt i kësaj Marrëveshjeje.

9. Huadhënësi nuk duhet të favorizojë ndonjë prej Huamarrësve, mbi bazën e kritereve të tij preferenciale.

10. Huadhënësi duhet të vendosë në dispozicion të MFE-së (ose çdo strukture tjetër të autorizuar nga MFE-ja për këtë qëllim), me kërkesë të kësaj të fundit, kopje të dosjeve, të ekstrakteve, të dokumenteve, të dhënave të regjistruara dhe të shkresave të të gjitha Huave që i nënshtrohen kësaj Marrëveshjeje Garancie.

11. Huadhënësi, shqyrton dokumentacionin e nevojshëm dhe aprovon Huanë në përputhje me afatet dhe procedurat e tij të brendshme, si dhe garanton kalimin e fondeve në llogarinë e Huamarrësit, sipas pikës 1 të nenit 5, si dhe përdorimin e Huasë për qëllimin e mbuluar nga Garancia Shtetërore për rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar të Huamarrësit, i cili është prekur direkt ose indirekt nga aktet ligjore dhe nënligjore të qeverisë në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19.

Neni 5
(Termat dhe kushtet e Huasë)

1. Vlera e Huasë e vendosur në dispozicion nga Huadhënësi për Huamarrësin mund të variojë në përputhje me kërkesën e paraqitur nga Huamarrësi, por në asnjë rast nuk do të jetë më e lartë se 300,000,000 (treqind milion) lekë.

2. Pavarësisht pikës 1, në asnjë rast shuma e Huave me vlerë më të lartë se 150,000,000 (njëqind e pesëdhjetë milion) lekë nuk duhet të jetë më e lartë se 50% e shumës së Huave të akorduara nën këtë Marrëveshje.

3. Afati i Huasë duhet të jetë në diskrecion të Huamarrësit, por duke mos tejkaluar në asnjë rast afatin prej 5 (pesë) vite.

4. Huaja mund të jetë në formën e kredisë, overdraft-it, ose linjës së kredisë, e vlerësuar kjo në përputhje me nivelin e riskut të kredisë dhe preferencat e Huamarrësit.

5. Pavarësisht produktit me të cilin do të ofrohet Huaja, periudha pa pagesë principali nuk do të jetë më pak se 6 muaj, me përjashtim të rasteve kur Huamarrësi preferon një periudhë më të shkurtër.

6. Në rastet e parapagimit të Huasë, Huadhënësi nuk duhet të aplikojë komision, penalitet apo cfarëdo lloj mase tjetër që lidhet me parapagimin e Huasë.

7. Monedha e Huasë duhet të jetë në monedhën vendase (lekë).

8. Huadhënësi duhet të ofrojë Huanë me një normë interesi vjetore preferenciale, të barabartë me: (i) normën mesatare të interesit të tre bonove të thesarit 12 mujore më të fundit të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë (referenca/indeksi), plus (ii) një marzh deri në 3.0% në varësi të afatit të Huasë dhe produktit me të cilin do të ofrohet Huaja. Norma vjetore e interesit do të jetë e ndryshueshme mbi bazë vjetore në varësi të referencës/indeksit, por duke parashikuar shprehimisht që në asnjë rast norma vjetore e interesit të mos tejkalojë vlerën prej 5.0%.

9. Huadhënësi, bazuar në vlerësimet e riskut të kreditit për secilin Huamarrës gëzon të drejtën që të kërkojë ose jo kolateral shtesë nga Huamarrësi, por në asnjë rast masa e alokuar e kolateralit duke përfshirë edhe Vlerën e Garantuar të Huasë sipas kësaj Marrëveshjeje nuk duhet të tejkalojë mbulimin e përlogaritur sipas legjislacionit dhe rregullave të brendshme të Huadhënësit.

10. Termat dhe kushtet e Huasë do të përcaktohen në Marrëveshjen e Huasë, e cila do të nënshkruhet ndërmjet Huadhënësit dhe Huamarrësit, në përputhje me përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje. Termat dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë të cilat bien në kundërshtim me këtë Marrëveshjeje do të konsiderohen të pavlefshme dhe nuk do të prodhojnë asnjë efekt kundrejt MFE-së.

11. Asnjë transferim i të drejtave apo detyrimeve të Huadhënësit që burojnë nga kjo Marrëveshje ose nga Marrëveshja e Huasë nuk mund t'i transferohet palëve të treta pa marrë paraprakisht aprovimin me shkrim të MFE-së.

12. Për çdo ndryshim, rinovim apo ristrukturim të Marrëveshjes së Huasë, që mund të bëhet në marrëveshjen ndërmjet Huadhënësit dhe Huamarrësit brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, nuk është i nevojshëm miratimi i MFE-së, me kusht që këto ndryshime nuk do të kenë asnjë efekt në të drejtat e Huadhënësit kundrejt MFE-së, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshjeje. Huadhënësi do të njoftojë me shkrim MFE-në (ose çdo strukturë të autorizuar nga MFE-ja) për çdo ndryshim, rinovim apo ristrukturim të Marrëveshjes së Huasë.

13. Huadhënësi është përgjegjës që totali i shumës së Vlerës së Garantuar të Huave, të mos tejkalojë Vlerën e Garancisë të lëshuar nga MFE-ja në favor të tij sipas nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje. Në asnjë rast, tejkalimi i Vlerës së Garancisë nuk do të përbëjë detyrim për MFE-në.

14. Huaja do të quhet e përfunduar dhe nuk do të jetë më objekt i kësaj Marrëveshjeje vetëm pasi të jetë paguar plotësisht nga Huamarrësi në përputhje me termat dhe kushtet e Marrëveshjes

së Huasë. Huadhënësi duhet të njoftojë me shkrim MFE-në për të gjitha Huatë e përfunduara brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh kalendarike nga data e përfundimit të tyre.

Neni 6

(Procedurat për kryerjen e pagesave të garancisë)

1. Kur Huamarrësi nuk ka mundur të kryejë pagesën e detyrimeve apo është në kushtet e ndonjë prej rasteve të tjera të mospërbushjes, të përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë dhe kur Huadhënësi brenda një periudhë jo më pak se 180 ditë kalendarike (nga dita e parë e lindjes së detyrimit nga Huamarrësi) ka ndërmarrë të gjitha hapat e përcaktuara në procedurat dhe politikat e tij të brendshme për ndjekjen e huave të papaguara, atëherë Huadhënësi rezervon të drejtën për t'i dërguar MFE-së kërkesën me shkrim për pagesën e detyrimeve ("Kërkesa për Pagesë") të Huave që i nënshtrohen kësaj Marrëveshjeje.

2. Kërkesa për Pagesë që Huadhënësi do t'i drejtojë MFE-së duhet të përmbajë:

a) Vlerën e pagesës të përlogaritur në përputhje me pikën 3 të nenit 2, kopje të Marrëveshjes së Huasë, si edhe një përshkrim të detajuar të detyrimeve, duke përcaktuar në mënyrë analitike principalin, interesat e akumuluar, penaltetet, dhe çdo detyrim tjetër në zbatim të Marrëveshjes së Huasë dhe që është në ngarkim të Huamarrësit, pavarësisht se MFE-ja garanton vetëm principalin në masën 60%.

b) Një përshkrim të të gjithë procedurave të ndjekura nga Huadhënësi përgjatë periudhës 180 ditore për të recuperuar detyrimet nga Huamarrësi, nga momenti i gjenerimit të detyrimit deri në momentin e dërgimit të Kërkesës për Pagesë.

c) Numrin e llogarisë bankare në të cilin do të kryhet pagesa nga MFE-ja.

3. MFE-ja, pasi vëren se Kërkesa për Pagesë është në përputhje me pikën 2 të këtij neni dhe kushtet që bëjnë të nevojshme paraqitjen e një kërkesë të tillë sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së Huasë, autorizon transfertën e pagesës ose pagesave për Huadhënësin brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e marrjes së Kërkesës për Pagesë.

4. Nëse MFE-ja e vlerëson të arsyeshme, përpara autorizimit për kryerjen e pagesës dhe brenda afateve të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, mund të kërkojë informacion shtesë ose qartësime nga Huadhënësi.

5. MFE-ja nuk ka asnjë detyrim ndaj Kërkesave për Pagesë, të cilat mund të burojnë nga vjedhja, materializimi i risqeve operacionale të Huadhënësit, ose për çdo arsye tjetër që nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje.

Neni 7

(Rikuperimi post-pagesës së garancisë)

1. Pas pagesës së garancisë për ndonjë prej Huave, MFE-ja merr në dorëzim automatikisht të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore, që zotëronte Huadhënësi ndaj Huamarrësit, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së Huasë dhe në masën e çdo pagese të kryer nga MFE-ja në kuadër të garancisë për këtë Hua. Këto të drejta dhe mjete ligjore i kalojnë MFE-së, së bashku me të drejtat dhe mjetet ligjore që ai ka në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit.

2. Pavarësisht pikës 1 të këtij neni, me përjashtim të rasteve kur:

a) MFE-ja njofton me shkrim Huadhënësin se do të ndjekë vetë procedurat për rikuperimin e detyrimeve të saj; dhe

b) Palët bien dakord që të ndalojnë ndjekjen e procedurave për rikuperimin e detyrimit në kushtet që vlerësojnë se kostot e këtyre procedurave tejkalojnë masën e detyrimit;

Huadhënësi do të ndjekë të gjitha procedurat e rikuperimit të detyrimeve, në përputhje me procedurat ligjore dhe praktikat e sektorit bankar, për të gjithë shumën e detyrimit të Huamarrësit, duke pasur detyrimin për të njoftuar pa vonesë MFE-në për çdo veprim procedural

me qëllim që të mos cënohen të drejtat materiale apo procedurale të MFE-së. Në rastin kur MFE-ja njofton me shkrim Huadhënësin se do të ndjekë vetë procedurat për rikuperimin e detyrimeve të saj, të dy palët ndjekin në mënyrë të pavarur rikuperimin e detyrimeve të tyre në masën përkatëse.

3. Nëse pas pagesës së garancisë nga MFE-ja për ndonjë prej Huave, Huadhënësi ndodh që të rikuperojë një pjesë ose të gjithë detyrimin e Huasë që paraprakisht është paguar nga garancia, Huadhënësi brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune duhet të njoftojë me shkrim MFE-në në lidhje me vlerën e rikuperuar, procedurat e rikuperimit, shpenzimet e rikuperimit dhe çdo detaj tjetër që gjykon të arsyeshëm në lidhje me rikuperimin. Menjëherë pas marrjes së njoftimit, MFE-ja do të instruktojë me shkrim Huadhënësin në lidhje me detajet e pagesës. Afati për kryerjen e pagesës nga Huadhënësi në favor të MFE-së do të jetë si më poshtë:

a) Në rastin kur rikuperimi është në formën e mjeteve monetare (cash), pagesa do të kryhet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e marrjes së instruksioneve me detajet e pagesës nga MFE-ja.

b) Në rastin kur rikuperimi nuk është në formën e mjeteve monetare, pagesa do të kryhet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e konvertimit të rikuperimit në mjete monetare (*cash*). Konvertimi i rikuperimit në mjete monetare (cash) do të kryhet në përputhje me procedurat dhe politikat e Huadhënësit për këtë qëllim.

4. Në rast se Huamarrësi, përveç detyrimit që buron nga Huaja nën këtë Marrëveshje Garancie ka edhe detyrimet të tjera ndaj Huadhënësit, atëherë ndjekja e detyrimit që buron nga kjo Hua do të ndiqet njëkohësisht me ndjekjen e detyrimeve të tjera, pa asnjë lloj diskriminimi nga Huadhënësi, dhe çdo rikuperim i detyrimeve prej këtij Huamarrësi do të alokohet proporcionalisht me masën e detyrimeve që ai ka ndaj MFE-së dhe ndaj Huadhënësit. I njëjti parim do të jetë i vlefshëm edhe në rastin e pagesave të pjesshme që mund të kryhen nga Huamarrësi.

Neni 8

(Raportimi dhe monitorimi)

1. Huadhënësi çdo të hënë do të raportojë në formë elektronike pranë MFE-së (ose strukturës që do të autorizojë MFE-në për këtë qëllim) për Huatë e aprovuara prej tij në javën paraardhëse, duke përcjellë shumën e disbursuar, skedulën e amortizimit të Huave, Marrëveshjen e Mirëkuptimit origjinale, si edhe kopje të dokumentave shoqëruese që vërtetojnë kriteret e kualifikimit të Huamarrësve dhe kriteret për përfitimin e Huasë sipas nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Huadhënësi gjithashtu do të raportojë në formë elektronike në bazë mujore pranë MFE-së (ose strukturës që do të autorizojë MFE-në për këtë qëllim), jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga mbyllja e secilit muaj, ecurinë e shlyerjes së Huasë, duke përfshirë në raportim informacion në lidhje me pagesat e kryera të Huasë nga Huamarrësi dhe vlerën e mbetur të Huasë.

3. Raportimet në lidhje me këtë nen, si dhe për nenet e tjera të kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhen në formë elektronike ose me shkrim sipas rasteve të përcaktuara në nenet përkatëse. Ato duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme:

Për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë:

[Adresa]

Në vëmendje të:.....

E-mail:

Faks:

Për Bankën XYZ:

[Adresa]
Në vëmendje të:.....
E-mail:
Faks:

Neni 9
(Zgjidhja e mosmarrëveshjeve)

Çdo mosmarrëveshje, kundërshti apo pretendim që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, apo shkelja, zgjidhja ose pavlefshmëria e saj, do të zgjidhet me mirëkuptim nga palët. Nëse palët nuk arrijnë t'i zgjidhin ato me mirëkuptim, ato do të zgjidhen sipas legjislacionit shqiptar.

Neni 10
(Vlefshmëria e dispozitave)

Nëse ndonjëra nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është apo bëhet e pavlefshme, ose në rast se ka ndonjë boshllëk në ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11
(Hyrja në fuqi dhe efektiviteti)

Kjo Marrëveshje Garancie do të hyjë në fuqi, pas nënshkrimit nga palët dhe do të bëhet efektive pas disbursimit të Huasë ndërmjet Huadhënësit dhe Huamarrësit.

Neni 12
(Nënshkrimi)

Palët kontraktuese nënshkruajnë këtë Marrëveshje në 2 kopje origjinale të barazvlefshme në gjuhën shqipe (një kopje për MFE-në dhe një kopje për Huadhënësin), në Tiranë, Shqipëri, në datat e përcaktuara në krye të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13
(Përfundimi dhe pezullimi i Marrëveshjes)

1. Kjo Marrëveshje Garancie do të quhet e përfunduar kur të gjitha detyrimet ndërmjet palëve, të cilat burojnë nga Marrëveshja e Huasë dhe kjo Marrëveshje të jenë përmbushur plotësisht, në rast se nuk do të kërkohet përfundimi përpara kohe i saj nga ana e MFE-së ose Huadhënësi. Në rast se do të kërkohet përfundimi i kësaj Marrëveshjeje përpara kohe, ky proces nuk do të ndikojë në detyrimet e lindura deri në atë moment.

2. MFE-ja mund të pezullojë Marrëveshjen e Garancisë në çdo kohë, duke e njoftuar me shkrim Huadhënësin, në rast të ndodhjes së ndonjë prej ngjarjeve të mëposhtme:

- a) Në rast se MFE-ja vërteton se Huadhënësi ka kryer një shkelje të kësaj Marrëveshjeje, ose është përshirë në një mashtrim i cili ka ndikim të drejtëpërdrejtë tek MFE-ja;
- b) Në rast se Huadhënësi nuk ka bërë asnjë disbursim huaje brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Garancisë.

KËSHILLI I MINISTRAVE
PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTËR
[EMËR MBIEMËR]

BANKA XYZ
ADMINISTRATOR
[EMËR MBIEMËR]

Aneksi 1

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI (FORMAT TIP)

Bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe nenin 676, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar:

[Emërtimi i Huamarrësit] bie dakord të nënshkruaj këtë Marrëveshje Mirëkuptimi në datën ____/____/2020 për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga lëshimi Garancisë Shtetërore të Huasë, sipas Marrëveshjes së Garancisë nr._____, datë____/____/2020.

Huamarrësi X bie dakort të nënshkruajë Marrëveshjen e Mirëkuptimit datë ____/____/2020 për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga lëshimi i Linjës së Garancisë Qeveritare, sipas Linjës së Garancisë Nr._____, datë____/____/2020.

Në rast kompensimi të humbjeve nga MFE-ja për pagesa që burojnë nga Marrëveshja e Huasë sipas Marrëveshjes së Garancisë cituar në pragrafin e mësipërm, [Emërtimi i Huamarrësit] bie dakord që të bëjë përpjekje të arsyeshme për t'i kthyer MFE-së shumën/shumat që kjo e fundit i ka paguar Huadhënësit, përfshirë edhe të gjitha kostot që mund të lidhen me to.

Në rast të kundërt, [Emërtimi i Huamarrësit] është në dijeni se MFE-ja rezervon të drejtën për të ndërmarrë të gjitha masat e përcaktuara në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si edhe në ligje të tjera në fuqi për të përfituar kthimin e çdo kompensimi të kryer sipas Marrëveshjes së Garancisë.

[Emërtimi i Huamarrësit]
Nënshkrimi